

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Karburant**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Karburante – 09100000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**16,341,330(gjashtembedhjetemilion e treqindedyzeteenjemije e treqindetridhjete) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Porttural Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar

## 2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

### 2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime për realizim të suksesshem të kontratës të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar*

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **“Liçensë”** ose Autorizim për tregtim karburantesh të leshuar nga organet kompetente.

### **Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “”Për përcaktimin e procedurave

dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore..

- Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht **2 (dy)** stacione të tregëtimit me pakice të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës, vertetuar me një nga format e disponimit sipas kodit civil (kontrate noteriale qeraje ose akt pronësie,ose të jete të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës ;

#### **Argumentim:**

Duke qene se Autoriteti Portual ka një numër të konsiderueshëm mjedesh, do të ishte e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 2 stacione të tregëtimit me pakice të karburantit. Për vendosjen së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se ka një numër operatorësh që kanë më shumë se 2 (tre) stacione të tregëtimit me pakice të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës.

- Stacionet e tregëtimit me pakice të karburanteve detyrimisht duhet të jete të pajisur me leje mjedisore të tipit C të lëshuar nga QKL.

#### **Argumentim :**

Kërkesa e mesipërme është kërkuar në zbatim të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT\* Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

Sistemi i lejeve të mjedisit 1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:  
c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji. 2. Aut

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotokopje të deklaratave doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit,nga data e hapjes së ofertave.

#### **Argumentim:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotokopje të deklaratave doganore të produktit të furnizuar gjatë 6 muajve të fundit , këto dokumente OE nëse nuk është vetë importues mund ta marrë nga importuesi.Kjo deklaratë krijon siguri që karburanti të jete me cilësi sipas normave

nderkombetare,dhe sipas normave te percaktuara nga ISHTI te jete i importuar dhe jo karburant vendi.

- Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim teknik te leshuar nga ISHTI ose Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit (OMVK),leje mjedisore te tipit B,te leshuar nga QKL,Certifikate e mbrojtjrs nga zjarri MZSH, dhe police sigurimi leshuar nga shoqerite e Sigurimeve qe operojne ne Shqiperi,per depozitat e tregtimit me shumice qe verteton kapacitetet depozituese mbi 10.000 m3 lidhur me rezervat e operatorit ekonomik,per te garantuar vazhdimsi ne furnizim,sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.

**Argumentim:**

Kapaciteti e depozitave te rezervave qe eshte kerkuar eshte me minimumi i dispozites ligjore per per te plotesuar kushtet e pajisjes me licence te naftes dhe nenprodukteve te saj sipas VKM 790 date 02.12.2015 dhe qe garanton vazhdimesine ne furnizim per vete rendesine e Autoritetit Portual.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Certifikaten ISO 9001: 2015 ose ekuivalente,lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise, e cila te perfshije objektin e prokurimit,te jete e akredituar si dhe te jete e vlefshme.

**Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Certifikaten ISO 14001: 2015 ose ekuivalente,lidhur me sistemin e menaxhimit te mjedisit, e cila te perfshije objektin e prokurimit,te jete e akredituar si dhe te jete e vlefshme.

**Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Certifikaten ISO 45001: 2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jete e akredituar si dhe të jete e vlefshme.

#### **Argumentim:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Subjekti ofertues duhet të paraqese dhe deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet të deklaroje se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice në shërbim 24 ore me karte elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, me tollon ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

#### **Argumentim:**

Referuar kerkeses se mesiperme duke qene se Autoriteti Portual eshte ne sherbim operativ 24/7 lind nevoja e sherbimit 24 ore te furnizimit.

- Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera mbi **3 Autobote** te transportit te lendeve te rrezikshme me kapacitet mbajtes nga **1 000 – 20 000** litra. Autobotet duhet te jene te paisur me Leje Qarkullimi .Kolaudimi (Kontroll teknik), police sigurimi, dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtes.

**Argumentim:**

Sqarojme se APD kerkon sasi te konsiderueshme furnizimi me karburant per vete rendesine dhe emergjencat qe mund te dalin gjate punes ,1 apo 2 mjete nuk japin siguri ne furnizim ,pasi mund te kene difekte, sherbime , trafik ose mund te jene ne sherbim te OE diku tjeter .Duke qene se ne raste te vecanta jane kerkuar 2 autobote brenda dites,nje per vincat dhe nje ne depon e Autoriteti Portual.Nje vinc kerkon mesatarisht 7500 litra karburant , per te cilat kerkohet mbi 2 ore kohe furnizim per mbushjen e tyre.Ne rastet kur jane dy vinca per tu furnizuar sasi dhe koha dyfishohen , kjo sjell nje bllokim te punes ne perpunimin e mjeteve detare dhe kosto financiare qe do te buronte nga ky fakt do te ishte e larte per APD dhe do te kishte fitim te munguar.Per kete arsye jane kerkuar te kete 3 autobote te transportit te lendeve te rrezikshme me kapacitet mbajtës nga 1.000 — 20.000 litra

- Bazuar ne VKM nr.561 date 29. 07.2016” Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve ne njesine e qeverisjes se pergjithshme” Operatoret ekonomik pjesmeres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet autoriteti kontraktor.